



**British Gymnasium
of Technology**

RREGULLORE E BRENDSHME PËR ANKESA

DISPOZITATE PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

Shkolla “Gjimnazi Britanik për Teknologji SH. P. K.” është themeluar si shkollë me përgjegjësi të kufizuara në përputhje me dispozitat e statutit të shkollës. Qëllimi i kësaj rregullore është për t’i mundësuar nxënësit të pyesë ose të apelojë kundër një vendimi vlerësimi, përpjekja për të arritur marrëveshje ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit sa më shpejt të jetë e mundur, të standardizojë dhe regjistrojë çdo apel për të siguruar transparencë dhe drejtësi, për të lehtësuar të drejtën përfundimtare të një nxënësi për t’u ankuar në Pearson dhe të mbrojë interesat e të gjithë nxënësve .

Neni 2 - Fushëveprimi

2.1 Kjo rregullore për ankesa ka për qëllim të përcaktojë mekanizmat e shkollës “British Gymnasium of Technology”, në mënyrë që nxënësit e pakënaqur me vlerësimin të kenë një mekanizëm ku mund të ankohen, duke filluar nga shkolla e deri tek Pearson. Ajo merr parasysht kushtet e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe kërkesat e Pearson.

2.2 Rregullorja e ankesave ndaj vlerësimeve është në funksion për të gjithë nxënësit pa dallim. Cilido, sipas detyrës dhe kompetencave të veta, duhet të ndihmojnë që kjo rregullore të zbatohet me ndershmëri. Poashtu secili mësimdhënës me rastin e vlerësimit duhet të jau komunikojë nxënësve se mund të ankohen ndaj vlerësimit .

Neni 3 – Faza e parë e ankeses

Nxënësi i pakënaqur ndaj vlerësimit të mësimdhënësve të lëndëve përkatëse konsultohet me vlerësuesin (mësimdhënësin) brenda një jave pas vendimit të vlerësimit, për të diskutuar një vendim vlerësimi. Nëse nuk zgjidhen, atëherë çështjet dokumentohen dhe kalohet në fazën e dytë.

Neni 4 – Faza e dytë e ankeses

Rishikimi i vendimeve të vlerësimit nga komisioni i ankesave bëhet pas fazes së parë. Nxënësi do të njoftohet me vendimin e komisionit me shkrim, për ankesën ndaj vlerësimit.

Neni 5 – Faza e tretë e ankesës

Nëse nxënësi nuk pajtohet me vendimin e komisionit të ankesave atëherë kalohet në fazën tjetër. Faza e tretë e ankesës është seanca e apelimit, në të cilën menaxhmenti i lartë dëgjon ankesën. Kjo është faza e fundit që nxënësi mund të ankohet në shkollë dhe nëse nuk zgjidhet as në këtë fazë, atëherë kalohet në fazën e katërt.

Neni 6 – Faza e katërt (ankesa e jashtme)

Faza e katërt e ankesave bëhet pasi të jenë shterur i gjithë procesi i brendshëm i apelimit. Arsyet e nxënësit për apelim dhe çdo dokument mbështetës duhet të dorëzohen nga shkolla te Pearson, Brenda 14 ditëve nga përfundimi i fazes 3. Për këtë fazë vendoset një tarifë.

Neni 7 – Regjistrimi i ankesave

Secila fazë duhet të regjistrohet, të datohet dhe të tregojë ose dakordësi ose mospajtim me vendimet. Dokumentet duhet të mbahen të paktën 18 muaj.

Neni 8 – Monitorimi i ankesave

Monitorimi i ankesave bëhet nga menaxhmenti i lartë për të informuar zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë.

British Gymnasium of Technology, Rr. Dervish Qollaku, No. 76, 10000, Pristina

Tel: +38349441338

e-mail: info@bgt.school

web: <https://www.bgt.school/>